REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno Më/Dana 03.03.2011 | | | |
|---|---|---|---|
| Nr.I organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| 01-013/232 | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2 shkronja d), nenit 17 shkronja s), nenit 52 par. 2 lidhur me nenin 5 shkronja b) dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr 03/L-040 (G zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/2008) si dhe konform nenit 40 par. 2 të Ligjit për pasurinë dhe të drejtat sendore Nr 03/L-154, si dhe mbështetur në dispozitat e nenit 22 par. 2 lidhur me nenin 33.2 të Statutit të Komunës së Vitisë nr02-013/5156 të datës 18.11.2008, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më 28.02.2011 aprovon këtë:

# VENDIM

## PËR DHENJEN NË SHFRYTËZIM TË LOKALIT AFARIST NË NGASTREN KADASTRALE NR 3061

Neni 1.

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, për merita të veçanta të dhënë për çlirimin e vendit i JEP në shfrytëzim të përhershëm veteranit dhe invalidit të luftës z. Xhavit Hasanit lokalin afarist në ngastrën nr 3061 në sipërfaqe prej 158 m2 në vendin e quajtur " Komuna" që evidentohet në çertifikatën e pronës nr P -70101007-03061-0 ZK Viti pronë e Komunës së Vitisë.

Neni 2.

Dhënia në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, lokalit afarist nga neni 1 i këtij vendimi bëhet për shfrytëzim të përhershëm pa të drejtë tjetërsimi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

KRYETARI I KUVENDIT
Skenderbe Hebibi